

## Analize mbi

# Historiku i Amnistive Fiskale dhe Deklarimet Vullnetare të Pasurive në Shqipëri

Instituti Shqiptar i Shkencave / Open Data Albania

Punoi: Elivar Golemi, Korrik 2022

## I. Aspekti teorik dhe eksperiencia ndërkombëtare e amnistive fiskale

**Përkufizimi** - Termi amnisti nënkupton një akt faljeje nga ana e qeverisë, një vendim për të mos ndëshkuar një person, një biznes apo një entitet tjetër, për një apo disa keqbërje në shkelje të ligjit. Amnistia fiskale i referohet një trajtimi të favorshëm të detyrimeve tatimore, në formën e shmangies, faljes së plotë ose të pjesshme të taksave dhe gjobave, për individë/subjekte që kanë të ardhura, fonde apo pasuri të tatueshme, të paraportuara më parë (ose të raportuara gabim), përfshirë pasuritë e padeklaruara të mbajtura jashtë vendit (të njohura si programet e deklarimit vullnetar të pasurive -DVP), si dhe programet e riadhesimit të pasurive (FATF, 2012 – Shih **Aneksin 1** për përkufizimet)<sup>1</sup>.

**Format e amnistive fiskale dhe përfitimet** - Amnistia fiskale përbën një instrument të rëndësishëm në përdorim të qeverive, për qëllime të ndryshme, si rritja e të ardhurave buxhetore nga taksat, përmirësimi i shkallës së përputhshmërisë me detyrimet tatimore, dhe/ose lehtësimi i procedurave për riadhesimin e pasurive në mbështetje të politikave ekonomike (OECD, 2015)<sup>2</sup>. Në parim, të gjitha programet e amnistive fiskale synojnë të nxisin taksapaguesit, të cilët kanë shkelur ligjin, që të rregullojnë vullnetarisht çështjet e tyre tatimore në këmbim të një shkalle mbrojtjeje nga ndjekja ligjore. Megjithatë, programet specifike të deklarimit vullnetar të pasurive dallojnë nga amnistitë e drejtpërdrejta të taksave, pasi rezultati i pritur në rastin e parë nuk është falja e plotë apo e pjesshme e detyrimeve tatimore, por deklarimi i të ardhurave dhe pasurive të padeklaruara më parë, si pjesë e një strategjie kombëtare të përmirësimit të përputhjes me

---

<sup>1</sup> Financial Action Task Force (FATF), 2012 - Best Practices Paper: “Managing the antimoney laundering and counter-terrorist financing policy implications of voluntary tax compliance programmes”.

<sup>2</sup> Organisation for Economic Co-operation and Development (OECD), 2015 - Update on Voluntary Disclosure Programmes: “A Pathway to Tax Compliance”.

detyrimet fiskale, subjekt i rregullimeve dhe kërkesave të raportimit sipas standardeve të parandalimit të pastrimit të parave dhe luftës kundër terrorizmit (IMF, 2022).

Programet e deklarimit vullnetar të pasurive ndryshojnë shumë sipas vendeve, por në shumicën e rasteve synohet të shmangen (plotësisht ose pjesërisht) gjobat, kundrejt një norme të sheshtë takse mbi pasuritë e deklaruar vullnetarisht. P.sh. programi i deklarimit vullnetar të pasurive në Itali ofron dy alternativa: (i) mënyrën standarde – shlyerjen e plotë të detyrimeve tatimore për të ardhurat/pasuritë e padeklaruar, dhe (ii) mënyrën e thjeshtuar – shlyerjen e detyrimeve tatimore në normë të sheshtë taksash, e aplikueshme për rastet riatdhesimit të kapitalit, si dhe për taksapaguesit që kanë një balancë vjetore të mjeteve financiare që nuk kalon vlerën prej 2 milion euro për çdo vit të deklarimit vullnetar të pasurisë, siç detajohet në **Aneksin 2**.

## **II. Eksperienca dhe historiku i programeve të amnitive fiskale në Shqipëri**

**Procedura ligjore dhe konsensusi politik** - Për shkak të rëndësisë dhe efekteve afatshkurtra dhe afatgjata në ekonomi, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton se amnistia miratohet me shumicë të cilësuar (tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit / 84 vota)<sup>3</sup>, me qëllim që të arrihet dakordësia e opozitës dhe palëve të interesuara, përveç vullnetit të qeverisë që e propozon. Në rastet kur dakordësia nuk arrihet, siç ka ndodhur edhe në vitet e kaluara në Shqipëri, qeveria propozon forma alternative të legalizimeve dhe faljes/shuarjes së detyrimeve fiskale, të cilat ligjërisht mund të miratohen me shumicë të thjeshtë votash. Forma alternative të amnitive fiskale janë ndërmarrë disa herë në Shqipëri, siç paraqitet në **Tabelën 1**, periudha të caktuara kohe gjatë të cilave subjektet mund të deklarorin vullnetarisht pasuritë / rivlerësimin e pasqyrave financiare, si dhe të paguanin taksat e vonuara të periudhave të mëparshme, duke shmangur gjobat dhe penaltetet e tjera administrative.

Propozimet për amnisti fiskale kërkojnë konsultime të gjëra me palët e interesit dhe dakordësinë e aktorëve politikë, si faktori kryesorë për zbatimin me sukses të një programi DVP. Duke qenë një instrument në shërbim të qeverisë për rritjen afatshkurtër të të ardhurave buxhetore, kundërshtitë për programet e amnitive fiskale, përveçse nga ekspertët e ekonomisë dhe forca opozitare brenda vendit, kanë qenë të shpeshta edhe nga institucionet financiare ndërkombëtare, të cilat vlerësojnë se amnistitë e "suksesshme" janë përjashtimi dhe jo norma, prandaj qeveritë duhet të jenë shumë të kujdesshme kur propozojnë iniciativa të tilla.

Bazuar në eksperiencën e vendeve të tjera, popullariteti dhe suksesi i amnitive fiskale bazohet më shumë në perceptime sesa në fakte konkrete. Politikëbërësit zakonisht përdorin të ardhurat

---

<sup>3</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 81, pika 2, shkronja ë

bruto afatshkurtra për të vlerësuar efektet e një amnistie fiskale, por nuk marrin në konsideratë efektet afatgjata (IMF, 2008)<sup>4</sup>, si:

- a. shmangiet fiskale potenciale në të ardhmen si rezultat i humbjes së besueshmërisë ndaj administratës tatimore dhe efektet e pafavorshme nxitës që kjo krijon; dhe
- b. të ardhurave tatimore të munguara, të tilla si falja e detyrimeve dhe gjobave për të gjithë evazorët fiskalë, edhe pse disa prej tyre mund dhe duhet të ishin zbuluar nga administrata e taksave.

**Historiku i amnistive fiskale në Shqipëri** - Propozimi i parë për amnisti fiskale në Shqipëri i përket vitit 1999, me iniciativë të ish-Presidentit Rexhep Meidani, por që nuk u pranua as nga qeveria dhe as nga opozita e asaj kohe. Gjatë dy dekadave të fundit, në Shqipëri ka pasur të paktën dy iniciativa për amnisti fiskale bazuar në deklaram vullnetar të pasurive (2011 dhe 2020) në kuptimin e qasjes ligjore, por asnjëri prej propozimeve nuk ka gjetur konsensusin politik dhe të faktorit ndërkombëtar. Për këtë arsye, propozimi i vitit 2011 u miratua si iniciativë e thjeshta ligjore, me shumicë të thjeshtë votash dhe pa konsensusin e nevojshëm politik. Ndërsa propozimi i vitit 2020 vijon të jetë projekt, i ndryshuar në vitin 2022 dhe aktualisht në diskutim për dakordësinë e palëve të interesit dhe institucioneve ndërkombëtare. Në **Aneksin 3**, të listuara në kronologji kohore, detajohen iniciativat ligjore që kanë rregulluar programet alternative të faljes së detyrimeve fiskale në Shqipëri, deri në projekt-propozimin e fundit të vitit 2022.

**Tabela 1. Historiku i programeve të amnitisë fiskale dhe deklarimeve vullnetare në Shqipëri**

Viti	Baza ligjore	Objekti i programit	Afatet dhe rezultatet e vlerësuara
2008	Ligji nr. 9986, datë 11.09.2008	Falje e pjesshme e detyrimeve doganore dhe tatimore, të detyrimeve të prapambetura të taksës vjetore të qarkullimit rrugor dhe taksës së regjistrimit të përvitshëm të mjeteve, të gjobave e kamatëvonesave të papaguara, të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore të papaguara.	Afati i zbatimit: Tetor 2008 - Mars 2009  Rezultatet: Nuk ka të dhëna të publikuara lidhur me efektet e zbatimit të programit.
2010	Ligji nr. 10228, datë 04.02.2010	Legalizim kapitali / Rishikimi i ligjit "Për Tatimin mbi të ardhurat" për njohjen e të ardhurave në formë monetare për shtimin e kapitalit, me burime nga jashtë shoqërisë, kapitale që nuk janë deklaruar/tatuar më parë dhe që nuk janë të shoqëruara me dokumente zyrtare që	Afati i zbatimit: Nuk ka përcaktim  Rezultatet: Nuk ka të dhëna të publikuara lidhur me efektet e zbatimit të programit.

<sup>4</sup> IMF, 2008 - Tax Amnesties: Theory, Trends, and Some Alternative, Eric Le Borgne; Katherine Baer.

		vërtetojnë origjinën e të ardhurave.	
2011	Ligji Nr. 10418, datë 21.4.2011	Legalizim kapitali dhe falje e pjeshme e borxhit tatimor dhe doganor, i ndryshuar. Rivlerësimi i pasqyrave financiare deri në fund të vitit 2013.	Afati i zbatimit: Qershor – Dhjetor 2011 Efekte të pjeshme deri në 31.12.2013.  Rezultatet: (i) Vlera e kapitaleve të legalizuara 2011 - 2012: 270 miliardë lekë, nga të cilat, vlera monetare rreth 5 miliardë lekë (nga te cilat vetëm 0.5 milion euro përlllogaritet të jenë transferuar jashtë Shqipërisë). Të ardhura shtesë në buxhet: 2.85 miliardë lekë, shih <b>Aneksi 3</b> . (iii) Detyrimet fiskale të papaguara 2011–2012: falje e detyrimeve tatimore 26 miliardë lekë. Të ardhura shtesë gjithsej 607 milionë lekë, shih <b>Aneksi 5</b> .
2014	Ligji Nr. 39 datë 17.4.2014	Falje e plotë e dënimeve administrative në formën e gjobave, të vëna në bazë të kontrolleve dhe verifikimeve tatimore, për periudhën Mars–Gusht 2013.	Afati i zbatimit: Qershor - Tetor 2014  Rezultatet: Nuk ka të dhëna të publikuara lidhur me efektet e zbatimit të programit.
2015	Ligji Nr. 66, datë 14.07.2015	Falje e gjobave për mospagimin në afat të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga subjektet juridike dhe fizike.	Afati i zbatimit: Gusht - Tetor 2015  Rezultatet: Në total detyrime të falura për gjobat rreth 218 milionë lekë.
2017	Ligji Nr. 33, datë 30.03.2017	Falje dhe fshirje e detyrimeve tatimore të pagueshme në doganë, procedura e heqjes nga qarkullimi i mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore.	Afati i zbatimit: Maj - Dhjetor 2017  Rezultatet: Nga falja kanë përfituar rreth 195 mijë tatimpagues në shumën 49.8 miliard lekë (52% e totalit të detyrimeve tatimore).
2022	Projektligji 07.2020, i ndryshuar	Legalizim kapitali / Amnisti e përgjithshme fiskale dhe penale për subjektet që bëjnë deklaram vullnetar të pasurive, përfshirë riatdhesim të pasurive nga jashtë vendit.	Në fazë konsultimi publik

### III. Konkluzione të përgjithshme dhe opinione bazuar raportimet e KLSH

➤ **Analizë ekonomike: Programi i legalizimit të kapitaleve bazuar në deklaratimet vullnetare**

Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave<sup>5</sup>, gjatë periudhës 5-mujore Tetor 2011 - Shkurt 2012, shumat e kapitaleve të legalizuara ishin 270 miliardë lekë (rreth 2 miliardë euro), kryesisht rivlerësim i pasurive, me të ardhura shtesë në buxhet prej 2.85 miliardë lekë (normë mesatare tati prej 1.1%), shih **Tabelën 2**. Nga totali i kapitaleve të legalizuara, shumat në të holla e deklaruar rezultojnë të jenë rreth 4.9 miliardë lekë (39.5 milionë euro, nga të cilat 0.5 milionë euro përlllogaritjet të jenë transferuar jashtë Shqipërisë).

Gjithashtu, analiza e ndryshimit mujor të depozitave bankare në lek dhe euro konfirmon se programi i legalizimit të kapitalit në 2011, që i shtriu efektet pjesërisht edhe në periudhën 2012-2013, nuk krijoi flukse shtesë të legalizimit të mjeteve monetare në sistemin bankar<sup>6</sup>, shih **Grafikun 1**. Fakti që projektligji 2020/2022 parashikon legalizimin e pasurive të padeklaruara për një periudhë 30 vjeçare, është një tjetër element vlerësues se programi i legalizimit të pasurive të padeklaruara i vitit 2011 mund të quhet një “praktikë e dështuar” në funksion të normalizimit të ekonomisë shqiptare.

➤ **Analizë ekonomike: Programi i faljes së detyrimeve/borxhit tatimor të papaguar**

Sipas konstatimeve të KLSH-së në raportet vjetore të monitorimit të buxhetit, bazuar në ecurinë e borxheve tatimore, rezultojnë se:

⇒ Në fund të vitit 2011<sup>7</sup>, **detyrimet fiskale në total ishin rreth 65 miliardë lekë**, siç detajohet në **Tabelën 3**, nga të cilat 77% janë të trashëguara nga viti 2009 dhe më përpara, përkatësisht:

- deri në vitin 2005: 13.8 miliardë lekë detyrime;
- 2006-2007: 7.7 miliardë lekë detyrime;
- 2008: 8.4 miliardë lekë detyrime; dhe
- 2009: 19.8 miliardë lekë detyrime.

Pra, tendenca e krijimit të detyrimeve fiskale të papaguara ka qenë në rritje pas zbatimit të programit të parë të faljes së detyrimeve fiskale në vitin 2008, që nënkupton se falja e detyrimeve jo vetëm që nuk u shoqërua me reduktim të detyrimeve të prapambetura, por gjatë

<sup>5</sup> Të ardhura nga legalizimi i kapitaleve <https://www.financa.gov.al/te-ardhura-nga-legalizimi-i-kapitalit/>

<sup>6</sup> Burimi: Banka e Shqipërisë

<sup>7</sup> Raporti i KLSH për monitorimin e buxhetit të vitit 2011 <https://panel.klsh.org.al/storage/phpnEHUcE.pdf>

vitit 2009 pati një rritje shumë të lartë të detyrimeve fiskale, duke e rritur koston e informalitetit në ekonomi.

- ⇒ Në fund të vitit 2012<sup>8</sup>, detyrimet fiskale të papaguara ishin rreth 70 miliardë lekë (nga 65 miliardë lekë në fillim të vitit). Efektet e detyrimeve fiskale të falura nga zbatimi i ligjit nr. 10418/2011 “Për Legalizimin e Kapitalit dhe faljen e një pjese të Borxhit Tatimor dhe Doganor”, për periudhën 2011–2012, kanë ndikuar në **uljen e detyrimit tatimor prej 26.2 miliardë lekë**<sup>9</sup>, kundrejt të ardhurave të përfituara shtesë prej 607 milionë lekë.
- ⇒ Për vitin 2014<sup>10</sup> nuk ka evidenca në lidhje me efektet e zbatimit të ligjit nr. 39/2014 për faljen e gjobave, por konstatohet se, pavarësisht rritjes së masave shtrënguese lidhur me administrimin e detyrimeve tatimore, efektiviteti i tyre ka rënie të konsiderueshme (nga 15% e vlerës së mbledhur në 2013, në vitin 2014 rezultojnë se është mbledhur vetëm 6.1% e vlerës së masave shtrënguese).
- ⇒ Për vitin 2015<sup>11</sup>, në zbatim të Ligji nr. 66/2015, janë falur gjobat e lidhura me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të evidentuara deri në Dhjetor 2014, për subjektet juridike dhe fizike, në total **detyrime të falura në vlerën 218 milionë lekë**. Efektiviteti i masave shtrënguese mbetet në nivel të ulët, ku rezultojnë se gjatë vitit 2015 janë mbledhur vetëm 5.7% e vlerës së masave shtrënguese, më i ulët se efektiviteti i masave shtrëngues gjatë vitit 2014
- ⇒ Për vitin 2017<sup>12</sup>, borxhi tatimor u ul në 96 miliardë lekë (nga detyrimi 147 miliardë lekë në fillim të vitit), kryesisht për shkak të efekteve të zbatimit të Ligjit të faljes nr. 33/2017 në vlerën prej 50 miliardë lekë (shih **Tabelën 4**), fshirjes së borxhit tatimor të akcizës me justifikimin e borxhit “të transferuar” drejt Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në vlerën 12.3 miliardë lekë, dhe rritjes së borxhit tatimor me 10.5 miliardë lekë. Në fund të 2017, në zbatim të ligjit të faljes nr. 33/2017, shumica e falur për 50 tatimpaguesit përfitues më të mëdhenj rezultojnë rreth 22 miliardë lekë, sipas detajimeve të **Tabelës 4.1**. Rritja e borxhit tatimor doganor gjatë vitit 2017 me rreth 11.5 miliardë lekë detyrime të papaguara, kur ka pasur disa amnisti fiskale për faljen e detyrimeve tatimore, tregon që këto amnisti, të cilat duhet të ndodhin shumë rrallë, duhet të jenë të mirëmbledhura dhe patjetër të shoqërohen me

<sup>8</sup> Raporti i KLSH për monitorimin e buxhetit të vitit 2012 <https://panel.klsh.org.al/storage/phpmAWkqW.pdf>

<sup>9</sup> Ligji nr. 10418, datë 21/4/2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, vlera e detyrimeve fiskale të falura vetëm gjatë vitit 2011 rezultojnë të jetë rreth 10.7 miliardë lekë.

<sup>10</sup> Raporti i KLSH për monitorimin e buxhetit të vitit 2014 <https://panel.klsh.org.al/storage/phpXf1kYR.pdf>

<sup>11</sup> Raporti i KLSH për monitorimin e buxhetit të vitit 2015 <https://panel.klsh.org.al/storage/phpD2B7io.pdf>

<sup>12</sup> Raporti i KLSH për monitorimin e buxhetit të vitit 2017 <https://panel.klsh.org.al/storage/phpHmpvnF.pdf>

marrjen e masave konkrete në drejtim të mbledhjes së borxhit nga organet tatimore dhe mirë administrimin e skemës së tatimeve, për të qenë efikase. Për më shumë, tendenca e faljeve të pjesshme të borxheve në vitet 2014-2015, si dhe pritjet për një falje të plotë të borxheve në vitin 2017, ndikuan në rritjen e borxhit tatimor gjatë vitit 2016, duke arritur peshën maksimale ndaj totalit të të ardhurave tatimore prej 40%, siç paraqitet në **Grafikun 2 (a/b/c)**.

- ⇒ KLSH ka konstatuar se gjatë realizimit të amnistisë fiskale të vitit 2017, janë fshirë nga regjistrat e borxhit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, detyrimet e akcizës për 49 tatim pagues me vlerë totale prej 12.3 miliardë lekë (detyrime, penaltete dhe kamatëvonesa), në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.33/2017 “Për pagesën dhe fshirjen/ shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë. Sektori energjetik (shoqëri me kapital shtetëror) ka përfituar nga amnistia e 2017, falje të detyrimeve tatimore në vlerë prej 9.6 miliardë lek, pavarësisht, detyrimet nga ky sektor vijojnë të jenë shumë të larta.

**Konkluzione të përgjithshme** - Nga ana e qeverisë nuk rezulton të jetë bërë një analizë gjithëpërfshirëse e efekteve në ekonomi të programeve të kaluara të faljeve/legalizimeve fiskale, për të konkluduar mbi efektivitetin e tyre, por në bazë të opinioneve dhe vlerësimeve të bëra nga auditimet e KLSH-së, mund të vlerësojmë se programet e amnistisë fiskale (falje të borxhit tatimor) në Shqipëri nuk kanë qenë të suksesshme në rezultatet e arritura për normalizimin e ekonomisë, madje detyrimet e papaguara fiskale janë rritur vit pas viti, tendencë në rritje pas çdo programi amnistie fiskale, apo pritje për një amnisti të re, duke materializuar kështu rrezikun që përsëritja e amnistive mund të sjellë humbjen e besimit të taksa paguesve në sistem, për rrjedhojë shmangien e detyrimeve tatimore në pritje të faljes së detyrimeve të papaguara. Shqipëria vijon të ketë një tregues informaliteti të lartë dhe sipas vlerësimeve të FMN-së më shumë se një e treta e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) krijohet nga ekonomia informale, normë kjo dy herë më e lartë se mesatarja e vendeve të Evropës. Ngarkesa fiskale dhe informaliteti i lartë janë dy nga problematikat kryesore që firmat shqiptare vlerësojnë si faktorë pengues për zhvillimin e biznesit (WB, 2022)<sup>13</sup>.

**Praktikat e mira dhe mbrojtja nga rreziqet** - Përpara se të propozohet një program për amnisti fiskale bazuar në DVP, vendi duhet të ketë një kuadër rregullativ të plotë dhe efektiv përsa i përket parandalimit të pastrimit të parave. Amnistia fiskale dhe riadhesimi i pasurive nuk janë në përputhje me rregullat e parandalimit të pastrimit të parave, nëse programi i propozuar ofron mbrojtje të plotë nga gjurmimet e autoriteteve lidhur me burimin e krijimit të të ardhurave, si dhe mbrojtje nga procedimi penal për pastrim të mundshëm parash (OECD, 2015). Programet specifike të riadhesimit duhet të shoqërohen me marrëveshje midis vendeve për shkëmbim

<sup>13</sup> WB, 2022 – Country Private Sector Diagnostic / Creating markets in Albania

informacioni mbi taksat dhe bashkëpunim në parandalimin e pastrimit të parave, në mënyrë të veçantë nga vendet offshore ku mbahen pasuritë e padeklaruar (IMF, 2022)<sup>14</sup>.

Kujdes i duhur duhet të ushtrohet për të gjithë taksapaguesit që deklarojnë dhe/ose riatdhetojnë pasurinë nga jashtë, së bashku me identifikimin e pronarit përfitues të llogarisë në të cilën do të deklarohen/riatdheshen pasuritë. Disa nga masat që zbatohen për të garantuar që amnistia fiskale nuk përbën një rrezik kundër pastrimit të parave<sup>15</sup>, janë:

- a. pasuritë e riatdhesuara ose të deklaruar depozitohen në një institucion financiar që është subjekt i masave kundër pastrimit të parave apo financimit kundër terrorizmit;
- b. pasuritë që vijnë nga vende që nuk zbatojnë siç duhet rekomandimet e organizatave ndërkombëtare të parandalimit të pastrimit të parave monitorohen me kujdes të veçantë; si dhe
- c. çdo deklaratë e lëshuar nga autoritetet kompetente nuk përbën një mbrojtje ligjore të pasurive të deklaruar apo të riatdhesuara, lidhur me origjinën e ligjshme ose jo të krijimit të tyre.

---

<sup>14</sup> IMF, 2022 - "Voluntary Disclosure Programs - Design, Principles, and Implementation Considerations.

<sup>15</sup> Financial Action Task Force (FATF), 2012



## Lista e Tabelave dhe Grafikëve

- Tabela 1. Historiku i programeve të amnistisë fiskale dhe deklarimeve vullnetare në Shqipëri
- Tabela 2: Legalizimi i kapitalit dhe të ardhurat e arkëtuara në zbatim të Ligjit nr 10418, datë 21.4.2011 " Për legalizimin e Kapitalit dhe Faljen e një pjese të Borxhit Tatimor dhe Doganor (excel)
- Tabela 3: Detajimi i stokut të detyrimeve fiskale të papaguara në fund të vitit 2011 (excel)
- Tabela 4 /4.1 Ecuria dhe gjendja e detyrimeve tatimore (4.a) dhe doganore (4b) të papaguara dhe të falura deri në 31.12.2017 (excel)
  
- Grafik 1: Efektet e amnistisë fiskale të vitit 2011 në depozitat në sistem bankar (excel)
- Grafik 2: Ecuria ndër vite, struktura sipas llojit të tatimeve dhe pesha e borxhit tatimor ndaj totalit të të ardhurave tatimore (excel)

## Lista e Anekseve

### Aneks 1. Përkufizime<sup>16</sup>

- a) Termi “riatdhësim pasurie” i referohet sjelljes (pra riatdhësimi) të fondeve ose pasurive të tjera nga jashtë vendit.
- b) Termi “amnistia tatimore (fiskale)” i referohet trajtimit të favorshëm të detyrimeve tatimore si shmangia e plotë ose e pjesshme nga çdo taksë, interes dhe gjobë që përndryshe do të paguheshin në lidhje me të ardhurat e tatueshme, fondet ose pasuritë e tjera të raportuara më parë (ose të raportuara gabimisht).
- c) Termi “deklarim vullnetar” i referohet deklarimit vullnetar pranë autoriteteve tatimore të çdo të ardhure të tatueshme, fondesh ose pasurish të tjera të raportuara (ose të raportuara gabimisht).
- d) Termi “program i përputhjes së taksave vullnetarisht” i referohet çdo programi të projektuar për të lehtësuar legalizimin e mjeteve financiare të taksapaguesit për fonde apo pasuri të tjera, të raportuara më parë ose të raportuara gabimisht.

### Aneks 2. Rasti i Italisë - Amnistia e Përgjithshme Fiskale, 2014<sup>17</sup>

Amnistia fiskale e vitit 2014 në Itali, e cila përfshinte edhe riatdhësim të kapitalit nga jashtë, me kohëzgjatje një vit, ofronte dy alternativa deklarimi vullnetar:

- i. metoda analitike" – ku pasuritë e deklaruara vullnetarisht taksoheshin me një normë të plotë, sikur të ardhurat të ishin deklaruar rregullisht gjatë viteve të përfshira në program - në varësi të llojit të të ardhurave, norma e taksave ishte 12.5 për qind, 20 për qind, 27 për qind ose 43 për qind (gjobat u minimizuan, të barabarta me 12,5 për qind dhe 20 për qind të taksave të papaguara);
- ii. "metoda e thjeshtuar" - e cila aplikohet vetëm për riatdhësimin e pasurive të huaja si dhe për taksapaguesit me një tepricë mesatare të llogarisë bankare që nuk kalonte 2 milion € në çdo vit fiskal të përfshirë në deklarimin vullnetar të pasurive – një normë e sheshtë taksash prej 5 për qind e aplikuar në vlerën e përgjithshme të pasurive të huaja dhe një normë prej 27 për qind ndaj të ardhurave të tatueshme.

Taksapaguesit kishin të drejtë për imunitet nga ndjekja penale për krime fiskale, por iu desh të deklaronin emrin, informacionin bankar dhe ndërmjetësit e tyre për t'u bërë të mundur autoriteteve të verifikonin origjinën e pasurive. Italia nënshkroi marrëveshje me Zvicrën fillimisht (ku mbaheshin shumica e

<sup>16</sup> Managing the AML/CTF Policy Implications of Voluntary Tax Compliance Programmes, FATF 2012.  
<http://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/reports/BPP%20VTC.pdf>

<sup>17</sup> *Burimi: Voluntary Disclosure Programs—Design, Principles, and Implementation Considerations, IMF*  
<file:///C:/Users/utente/Downloads/TNMEA2022002.pdf>



pasurive të padeklaruara nga taksapaguesit italian) dhe më pas me vendet e tjera, për një shkëmbim automatik të informacionit mbi taksat dhe bashkëpunimin kundër mashtrimit fiskal. Programi u realizua me dy faza: së pari, një inventar i pasurive të mbajtura në Zvicër u përgatit duke rindërtuar origjinën e tyre dhe duke llogaritur taksat dhe gjrobat, në mbrojtje të konfidencialitetit të taksapaguesit; së dyti, u morën masa për të paguar taksat dhe gjrobat në Itali. Asnjë dokument bankar apo informacion që identifikon taksapaguesin italian nuk u dërgua pranë autoriteteve tatimore përpara se klienti të pranonte formularin e deklarimit

### **Aneksi 3. Historiku u amnistive fiskale dhe faljeve te detyrimeve tatimore ne Shqipëri**

#### **1. Ligji nr. 9986, datë 11.09.2008 “Për faljen e detyrimeve doganore dhe tatimore, të detyrimeve të prapambetura të taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve e të taksës së regjistrimit të përvitshëm të mjeteve, si dhe të gjobave e kamatëvonesave të papaguara të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore”.**

Programi për falje të detyrimeve u propozua nga Këshilli i Ministrave dhe u miratua në Kuvend me shumicë të thjeshtë votash.

#### **Subjektet që përfituan nga programi:**

- Për personat fizikë e juridikë dhe për institucionet shtetërore dhe ndërmarrjet e shoqërive me kapital shtetëror - debitorë ndaj administratave doganore dhe tatimore - falen pjesërisht ose plotësisht detyrimet doganore/tatimore së bashku me gjrobat dhe kamatëvonesat.
- Për disa grupe si personat fizikë të vetëpunësuar, ndërmarrjet dhe shoqëritë me kapital shtetëror, institucionet shtetërore, etj, si dhe për personat juridikë e fizikë privatë, falen plotësisht ose pjesërisht detyrimet e papaguara për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, së bashku me gjrobat dhe kamatëvonesat.
- Për personat fizikë, individë, debitorë ndaj administratës tatimore dhe doganore, për automjetet e importuara, falen plotësisht ose pjesërisht detyrimet doganore, së bashku me kamatëvonesat dhe gjrobat, si dhe detyrimet e prapambetura për taksën vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve.

**Subjekte të përjashtuara:** Individët, personat fizikë dhe juridikë, debitorë ndaj administratës doganore e tatimore dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për të cilët ka filluar një procedim penal dhe që në përfundim të tij deklarohen fajtorë, apo detyrimi i të cilëve është përcaktuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, ose që e kanë paguar detyrimin, me të gjithë komponentët e tij, nuk ishin përfitues të faljes së detyrimeve, sipas dispozitave të këtij ligji.

#### **2. Ligji nr. 10228, datë 04.02.2010, i cili ndryshoi Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”.**



Ky ligj mundësonte rritjen e kapitaleve të shoqërive tregtare, të krijuara nëpërmjet të ardhurave të padeklaruar më parë nga individët, me qëllim për të legalizuar çdo aset të tyre të padeklaruar. Konkretisht rishikimi i ligjit "Për Tatimin mbi të ardhurat" mundësonte njohjen e të ardhurave në formë monetare për shtimin e kapitalit, me burime nga jashtë shoqërisë, kapitale që nuk janë të tatuara më parë dhe që nuk janë të shoqëruara me dokumente zyrtare, që vërtetojnë origjinën e të ardhurave. Propozimi u bë nga Këshilli i Ministrave dhe u miratua me shumicë të thjeshtë votash. Procedurat u përcaktuan me udhëzim të Ministrit të Financave.

**3. Ligji Nr. 10 418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, i ndryshuar (rivlerësimi i pasqyrave financiare deri në fund të vitit 2013).**

Amnistia fiskale e parë u propozua në Prill 2011, pas krizës financiare botërore të vitit 2008. Deklarimi vullnetar i pasurisë (DVP) ishte thelbi i programit të propozuar, në mënyrë që të shmangej evazioni fiskal në të ardhmen, dhe synonte legalizimin e pasurive dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor e doganor, ku përfshiheshin detyrimet tatimore të papaguara të individëve deri më 31 Dhjetor 2010. Pritjet e qeverisë ishin shumë të larta, por propozimi për amnisti të përgjithshme fiskale dhe penale nuk gjeti përkrahjen e opozitës dhe programi u miratua si një praktikë ligjore alternative për legalizimin e kapitaleve dhe faljen e një pjese të borxhit fiskal. Miratimi i ligjit u bë me shumicë të thjeshtë votash, me propozim të Këshillit të Ministrave dhe pa dakordësinë e opozitës.

**Subjektet që përfituan nga programi:**

- Deklarim/legalizim/rivlerësim kapitali dhe detyrimesh mbi baza deklarimi vullnetar:
  - o Individët, personat fizikë/juridikë mund të deklarojnë vullnetarisht kapitalin e padeklaruar më parë, ose të deklaruar gabim, kundrejt tarifës 3 për qind të shumës totale të deklaruar.
  - o Individët që kanë në pronësi pasuri të paluajtshme bëjnë rivlerësimin me vlerën e tregut, kundrejt një tarife 1 për qind e diferencës në vlerë, si dhe personat juridikë, që kanë të regjistruar në pasqyrat e tyre financiare pasuri me vlerë më të vogël se ajo e tregut, bëjnë rivlerësimin me vlerën e tregut kundrejt tarifave: 3 për qind të diferencës për pasuritë e paluajtshme dhe 5 për qind për makineri/pajisje.
  - o Subjektet/individët që deklarojnë vullnetarisht vlera monetare, të cilat dëshirojnë ti transferojnë jashtë shtetit përpara afatit 3-vjeçar nga data e legalizimit të tyre, u mbahet si penaltet 3 - 13 për qind e shumës së legalizuar, në varësi të periudhës së transferimit.
  - o Tatimpaguesit që kanë deklaruar detyrim tatimor më të vogël, mund të bëjnë deklarimin vullnetar real tatimor, përpara se ndaj tyre të fillonte një kontroll i administratës tatimore.



- Falja e detyrimeve tatimore, doganore dhe të tjera detyrime të mbartura ndër vite:
  - Falje e plotë/pjesëshme e detyrimeve tatimore dhe doganore, të individëve dhe personave fizikë të regjistruar si biznes i vogël, apo subjekt i TVSH-së, të mbetura të papaguara, sipas kushte dhe afateve kohore të përcaktuara në këtë ligj.
  - Falje e plotë/pjesëshme e gjobave dhe kamatëvonesave të papaguara për të gjithë debitorët ndaj administratës tatimore dhe doganore, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara.
  - Falje e plotë/pjesëshme e detyrimeve të tatimpaguesve të vetëpunësuar, përfshirë bujqësinë, të detyrimeve të papaguara që lidhen me kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për veten e tyre, sipas periudhave kohore të përcaktuar në këtë ligj.
  - Falje e plotë/pjesëshme e detyrimeve të prapambetura të pronarëve të mjeteve për taksën e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve dhe taksën vjetore të qarkullimit rrugor, sipas periudhave që kanë futur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë automjete dhe nuk kanë paguar detyrimet ndaj administratës doganore.
  - Falje e gjobave të papaguara nga drejtuesit e mjeteve apo pronarët e tyre, të vëna nga inspektorët e kontrollit rrugor deri në datën 31 dhjetor 2010.
  - Falje e plote/pjesëshme e detyrimeve të prapambetura për energjinë elektrike dhe konsumin e ujit, sipas periudhës se lindjes së detyrimit, për të gjithë debitorët familjarë, si dhe kamatëvonesat e përlllogaritura nga mospagesa e faturave, përfshirë grupet në nevojë.
  - Falje e detyrimeve të papaguara të tatimpaguesve nga veprimet me të ardhurat jotatimore, si pullë akcize, mospagesat për arka regjistruese, certifikata tatimore, shtypshkrime, etj.

**Subjekte të përjashtuara:** Nga falja e detyrimeve tatimore e doganore përjashtohen zyrtarët që kanë detyrimin për deklarim të pasurisë, si dhe personat juridikë, në të cilët këta zyrtarë kanë aksione apo kuota kapitali.

**4. Ligji Nr. 39 datë 17.4.2014 “Për faljen e dënimeve administrative në formën e gjobave, të vëna në bazë të kontrolleve dhe verifikimeve tatimore, të kryera për periudhën Mars – Gusht 2013”**

Kjo nismë ligjore synonte faljen e gjobave ndaj biznesit dhe sipërmarrjes të vendosura nga administrata si pjesë e detyrimit tatimor të tatimpaguesve, të vendosura gjatë periudhës së zgjedhjeve parlamentare (Mars - Gusht 2013). Ligji parashikon që brenda Tetorit 2013, administratat tatimore, qendrore e vendore, duhet të fshinte nga regjistrat gjobat e falura si dhe të bënte pasqyrimet e sakta.

**Subjektet që përfituan nga programi:**



- Falen gjobat e vendosura për tatimpaguesit, persona juridikë/fizikë, të vendosura si pjesë e detyrimit tatimor të papaguar, gjatë periudhës 1 Mars - 31 Gusht 2013.
- Falen gjobat e vendosura për tatimpaguesit, lidhur me punonjës të padeklaruar apo të deklaruar me vonesë, mosinstalim të pajisjeve fiskale apo moslëshim të kuponit tatimor.

**Subjekte të përjashtuara:** Përjashtohen nga falja e çdo dënimi administrativ (gjobës), të përcaktuar sipas nenit 3 të këtij ligji, masa e tatimit dhe kamatëvonesat, si dhe gjobat e parashikuara në nenin 3, të këtij ligji, të cilat janë të llogaritura dhe të regjistruara automatikisht nga sistemi informatik i tatimeve, për shkak të shkeljeve të dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

**5. Ligji Nr. 66, datë 14.07.2015** *“Për faljen e gjobave për mospagimin në afat të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga subjektet juridike dhe fizike”.*

Ligji u propozua nga Këshilli i Ministrave dhe u miratua me shumicë të thjeshtë votash. E drejta e subjekteve që përfitonin nga dispozitat e këtij ligji mund të ushtrohej në periudhën Gusht – Tetor 2015. Brenda 3 muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, administrata tatimore fshin dënimet administrative, të falura sipas ligjit, dhe bën pasqyrimet konkrete të fshirjes në regjistrat e saj.

**Subjektet që përfituan nga programi:**

- Falen gjobat e lidhura me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të cilat janë evidentuara deri më 31.12.2014, në zbatim të neneve 113 “Mosdeklarimi në afat” dhe 114 “Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, për subjektet juridike dhe fizike, kur kontributi dhe kamatëvonesa është paguar plotësisht deri në datën 30.09.2015. Gjobat në proces apelimi administrativ/gjyqësor falen, sipas përcaktimeve të nenit 1, të këtij ligji.

**Subjekte të përjashtuara:** Gjobat për mosdeklarimin dhe mospagimin në afatet ligjore të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe të sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, të paguara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk kthehen.

**6. Ligji Nr. 33, datë 30.03.2017** *“Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore të pagueshme në doganë, si dhe procedura e heqjes nga qarkullimi i mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore”*

Të gjithë tatimpaguesit e regjistruar në regjistrin aktiv, pasiv ose të çregjistruar, që kanë detyrime tatimore të papaguara ndaj administratës tatimore qendrore e vendore, mund të përfitojnë nga fshirja/falja, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj. Drafti i parë i ligjit të faljes u kundërshtua nga FMN, e cila kërkoi që të fshiheshin vetëm ato detyrime që ishin të pamundura për t'u mbledhur dhe të bëhej maksimumi për të arkëtuar detyrimet e mbledhshme. Propozimi nuk pati dakordësinë e opozitës dhe për këtë arsye u miratua me shumicë të thjeshtë votash, pas

amendimeve të bëra draftit të parë të ligjit. E drejta e subjekteve që përfitonin nga dispozitat e ligjit mund të ushtrohej në periudhën Qershor - Dhjetor 2017.

**Subjektet që përfituan nga programi:**

- Fshihen detyrimet tatimore dhe doganore të papaguara që i përkasin periudhave tatimore deri në Dhjetor 2010, detyrimet e papaguara të përcaktuara sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, detyrimet e pagueshme në doganë për importin e produkteve të duhanit, si dhe TVSH e shtyrë dhe e paguar për makineritë e pajisjet.
- Fshihen gjobat dhe kamatëvonesat që rezultojnë të papaguara në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kushtin që brenda datës 31.12.2017, të paguhet të gjitha detyrimet tatimore, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dhe taksat vendore të papaguara, për periudhat tatimore Janar 2011 - Dhjetor 2014.
- Falen gjobat e vendosura si pjesë e detyrimit tatimor, në regjistrat e administratave tatimore, qendrore dhe vendore për periudhën Mars–Gusht 2013, ndaj tatimpaguesve, përfshirë gjobat që janë ankimuar apo në proces gjyqësor, si dhe gjobat administrative për punonjës të padëklaruar/deklaruar me vonesë, për mosinstalim të pajisjeve fiskale apo moslëshim të kuponit.
- Fshihen/falen detyrimet e mëposhtme, sipas periudhave tatimore të përcaktuara në ligj:
  - a) detyrimet tatimore përfshirë kontributin, kamatëvonesën dhe dënimet administrative për subjektet persona fizikë ose juridikë, të çregjistruar në QKB;
  - b) gjobat tatimore të llogaritura automatikisht nga sistemi për deklarim të vonuar deri 2016;
  - c) dënimet dhe gjobat tatimore që lidhen me afatin e deklarimit të të punësuarve, për dorëzim të vonuar të vendimit për destinimin e rezultatit dhe dorëzim me vonesë të pasqyrave financiare, për mosdeklarim në afat, për deklarata të padorëzuara, me kusht që çdo deklaratë e padorëzuar të dorëzohet deri në datën 30.6.2017;
  - d) detyrimet tatimore të papaguara, plotësisht ose pjesërisht dhe gjobat e kamatëvonesat, për shoqëritë me kapital shtetëror në sektorët elektroenergjetik dhe ujësjellëskanalizime. Fshihen gjobat dhe kamatvonesat për kontributet e sigurimeve dhe detyrimet e vetëdeklaruara për këto periudha, me kusht që detyrimi të paguhet i plotë.
- Fshihen/shuhet dënimet administrative (gjobat) dhe kamatëvonesat për sigurimet shoqërore e shëndetësore që i përkasin periudhave tatimore përpara 31.12.2010; detyrimet e pagueshme në doganë, të evidentuara nëpërmjet vendimeve të administratës, në periudhën 2011 - 2014, me kusht që brenda datës 31.12.2017 të paguhet i plotë detyrimi në doganë; për detyrimet e pagueshme në doganë, për shkelje të regjimit të lejimit të përkohshëm për automjetet, në periudhën 2011 - 2016, me kusht që brenda datës 31.12.2017 të paguhet i plotë detyrimi i pagueshëm në doganë.

**Subjekte të përjashtuara:** Përjashtohen nga fshirja/shuarja e detyrimeve të parashikuara sipas këtij ligji subjektet që kanë detyrime tatimore/doganore, të cilat janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën tatimore dhe/ose doganore, në kuptim të legjislacionit të fushës.

7. Projektligji "*Për amnistinë fiskale dhe penale për subjektet që bëjnë deklaram vullnetar të pasurive*", *i propozuar në Korrik 2020, i ndryshuar në Korrik 2022. ne Korrik 2022 ky draft wshtw thjeshtw nw proces konsultimi publik.*

Sipas relacionit të projektligjit tw 2020, ky program synon të krijojë premiset për një amnisti të përgjithshme fiskale dhe penale, me një afat 1-vjeçar zbatimi, për subjektet që deklarojnë vullnetarisht pasuritë, me qëllim të legalizimit të tyre dhe të formalizimit të aktiviteteve të krijuara gjatë 30 viteve të fundit, përfshirë legalizimin e pasurive të padeklaruara, të krijuara jashtë vendit dhe të mbajtura brenda ose jashtë vendit. Projektligji parashikon procedurat e deklaramit vullnetar dhe pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat dhe pasuritë që deklarohen vullnetarisht, përfshirë procedurat e riatdhesimit të pasurive që ndodhen jashtë vendit. Krahas aplikimit të një tatimi favorizues, projektligji garanton ruajtjen e konfidencialitetit të subjekteve dhe informacioneve që lidhen me këto pasuri, si dhe ofron mbrojtje penale për mosfillimin e procedurave hetuese dhe të procedimeve penale këtyre subjekteve, në lidhje me burimin e krijimit të pasurive të padeklaruara. Subjektet e këtij ligji mund të deklarojnë vullnetarisht pasuritë dhe elemente të pasqyrave financiare që nuk i kanë deklaruar më parë apo që i kanë deklaruar në një një vlerë më të vogël, pavarësisht faktit nëse pasuritë ndodhen ose jo në territorin e Republikës së Shqipërisë.

**Subjektet që propozohet të përfitojnë nga programi:**

- Individë shtetas, pavarësisht nëse janë rezidentë tatimorë ose jo në Shqipëri, persona fizikë dhe juridikë, tatimpagues rezidentë në Shqipëri, si dhe individë rezidentë tatimorë në Shqipëri pavarësisht shtetësisë së tyre. Pasuritë e deklaruara vullnetarisht, që ndodhen jashtë vendit mund të legalizohen dhe riatdhesohen kundrejt pagesës së tarifës së tatimit të posaçëm, sipas përcaktimeve në projektligj.
- Pasuria që lejohet të deklarohet vullnetarisht nuk duhet të kalojë vlerën maksimale 2 milion euro për taksapagues. Shumat në të holla të deklaruara në kuadër të këtij ligji nuk mund të transferohen jashtë shtetit për një periudhë 5 vjeçare nga momenti i depozitimit. Në rastet kur subjektet dëshirojnë të transferojnë këto shuma përpara afatit, mbahen penalite në masën 30% të shumës.
- Në rastet e deklarimit vullnetar të shumave në të holla dhe të depozitimit të tyre në llogaritë bankare, si dhe të pasurive të tjera të luajtshme apo të paluajtshme, norma e tatimit të posaçëm është: 7 për qind të shumës totale të deklaruar, për deklarime të kryera në 4 muajt e parë nga hyrja në fuqi e ligjit; dhe 10 për qind të shumës totale të deklaruar, pas 4 muajve nga hyrja në fuqi.



- Nëse subjektet që kanë bërë deklaram vullnetar të shumave në të holla nëpërmjet depozitimit të tyre në llogari bankare, vendosin ti investojnë shumat e deklaruara në tituj shtetërorë, me afat jo më të vogël se 2 vjeçar, norma e tatimit të posaçëm është: 5 për qind të shumës totale për investime të bëra në 4 muajt e parë nga hyrja në fuqi e ligjit; dhe 7 për qind të shumës totale për investime të bëra pas katër muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.

**Subjekte të përjashtuara:** Përjashtohen nga zbatimi i këtij ligji subjektet që kanë detyrimin ligjor për deklarimin e pasurisë, në zbatim të ligjit Nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe personat në përbërje të certifikatës familjare të tyre, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të detajuar në projektligj.